

ANALIZA E PREMTIMEVE ZGJEDHORE E SUBJEKTEVE POLITIKE ÇËSHTJET GJINORE - ZGJEDHJET 2024



Analiza e përfshirjes së çështjeve gjinore në programet e kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve

dhe

Analiza e përfshirjes së çështjeve gjinore në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 Shkup, Gusht 2024

Zbatuar nga:



International Foundation
for Electoral Systems



Përmbajtje

01

Hyrje

02

Përfaqësimi i çështjeve gjinore në programet e kandidatëve për President

Përfshirja e çështjeve gjinore

03

Përfundime përmbyllëse nga programet e kandidatëve për President

04

Përfaqësimi i çështjeve gjinore në programet zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare

Përfshirja dhe trajtimi i çështjeve gjinore

05

Përfundime përmbyllëse nga analiza krahasimore

06

Rekomandime

07

Pasqyrë e përfshirjes së premtimeve për çështjet gjinore në Programin e punës së Qeverisë 2024 - 2028

Analiza krahasimore e përfshirjes dhe trajtimit të çështjeve gjinore

08

Përfundime përmbyllëse nga analiza krahasimore

09

Rekomandime

Kjo analizë është zhvilluar në kuadër të Programit për mbështetjen zgjedhore të qeverisë së Zvicrës, zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë prezantim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit, projektit ose realizuesit.

01 Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2024 u zbatuan zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Zgjedhjet presidenciale u realizuan në rrethin e parë më 24 prill, ndërkaq rrethi i dytë u realizua më 8 maj së bashku me zgjedhjet parlamentare. Gjatë fushatës parazgjedhore për Presidentin e shtetit qytetarët patën mundësi që të njihen përsëafërmi me përcaktimet strategjike dhe me synimet e kandidatëve për President që u prezantuan në programet e tyre, ndërkaq fushata parazgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend i afrooi te qytetarët programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve.

Lënda e kësaj analize është e paraqitur në dy shkallë:

1. Përfaqësimi i çështjeve gjinore dhe fuqizimi i grave në programet e kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare. Në atë rast analiza i ka marrë parasysh programet e mëposhtme të partive politike dhe të kandidatëve për President^[1]:

- VMRO – DPMNE, Platforma “Maqedonia përsëri krenare” dhe kandidatja e tyre Gordana Siljanovska Davkova dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare i titulluar “Platforma # 1198”.
- LSDM dhe Koalicioni për Ardhmërinë Evropiane, programi zgjedhor i kandidatit për President Stevo Pendarovski ,Presidenti ynë Stevo“ dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare i titulluar “Programi për ardhmërinë evropiane 2024”.
- Fronti Evropian, Dekalogu i Presidentit Evropian me kandidatin për President Bujar Osmani dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Evropa 2030”.
- Koalicioni Vlen, programi zgjedhor i kandidatit për President Arben Taravari ,Platforma presidenciale“ dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Plani 2030”.
- E majta – Levica, programi zgjedhor i kandidates për Presidente Biljana Vankovska “E kthejmë dinjitetin e kombit” dhe programi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare “Të pakorruptueshmit në Kuvend”.
- GROM, programi zgjedhor “Trimërisht për Maqedoninë” i kandidatit për President Stevço Jakimovski.
- (Programi i kandidatit për President, Maksim Dimitrievski, nuk kishte qasje onlajn)

[1] Emërtimet e programeve dhe emrat e subjekteve politike janë marrë nga kopertinat e programeve të kandidatëve për President dhe programeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Në këtë mënyrë do të përdoren në mënyrë të njëkuptimshme nëpër tërë dokumentin. Gjithashtu, terminologjia që përdoret në këtë dokument në lidhje me emërtimet zyrtare, siç është emri i shtetit, përdoret në mënyrë identike siç është përdorur në programet zgjedhore të kandidatëve për President dhe në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare.

2. Përfshirja dhe trajtimi i çështjeve gjinore në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 me ç’rast kjo analizë i mori parasysh programet zgjedhore të subjekteve politike që e përbëjnë Qeverinë d.m.th:

- Programin zgjedhor të VMRO–DPMNE–së “Platforma # 1198”.
- Programin zgjedhor të Koalicionit VLEN “Plani 2030”.
- Programin zgjedhor të Lëvizjes ZNAM ,Manifest për Maqedoni të denjë”.

Çështjet gjinore janë bartur nga një cikël zgjedhor në tjetrin në programet zgjedhore të subjekteve politike në formë të njëjte a të ngjashme. Në anën tjetër, analizat e shumta tregojnë se realizimi i premtimeve lidhur çështjet gjinore gjithashtu ka qenë në shkallë të ulët. Kjo gjë tregon se këto çështje janë trajtuar sipërfaqësisht, ndonjëherë në nivelin e zotimeve deklarative dhe në mungesë të analizës më të detajuar rreth asaj se cilat janë nevojat e mirëfillta, detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare dhe standardet tanimë të vendosura në suazat e kornizës ligjore. Andaj, në këtë cikël zgjedhor është e rëndësishme të shqyrtohet vallë ka ndonjë strategji, gjegjësisht cila është strategjia e subjekteve politike lidhur me çështjet gjinore dhe të propozohen në mënyrë adekuate rekomandimet e caktuara për implementimin e më tejme të masave konkrete dhe të politikave, si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në atë vendore. Pikërisht kjo është një nga qëllimet e kësaj analize, e cila zbatimin e saj do ta gjejë në diskutimin publik në lidhje me zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, por edhe në periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve të ardhme lokale në vitin 2025.

02

Përfaqësimi i çështjeve gjinore në programet e kandidatëve për President

Nga analiza e përgjithshme e programeve të kandidatëve për Presidentin e shtetit mund të arrihet në përfundim se në përputhje me kompetencat që i mban ky post, fokusi është vënë në rendin kushtetues, sundimin e ligjit dhe drejtësinë, ruajtjen e sigurisë dhe identitetit kombëtar, politikën e jashtme, anëtarësimin në NATO dhe unifikimin e shtetit, ndërsa më pak në çështjet dhe politikat multisektoriale, siç janë çështjet gjinore.

Megjithatë, në programet e partive politike, siç janë: LSDM dhe Koalicioni për Ardhmërinë evropiane, VMRO–DPMNE dhe Fronti Evropian ose koalicioni VLEN, mund të vërehen edhe çështjet që kanë të bëjnë me gratë dhe rininë. Në vazhdim vijon një paraqitje e shkurtër e përfshirjes së këtyre çështjeve në programet e kandidatëve për President.

Përfshirja e çështjeve gjinore

Çështjet gjinore janë të përfaqësuara minimalisht në programet e kandidatëve për President. Pothuajse të gjithë kandidatët nuk përmenden fare çështjet gjinore, gjegjësisht çështjet e ndërlidhura me gratë. Përrjashtim bën programi i kandidatës Gordana Siljanovska Davkova. Për herën e parë në këto zgjedhje kishte dy gra kandidatë për presidente dhe programi i tyre ishte diametralisht i ndryshëm. Në programin e kandidatës Gordana Siljanovska Davkova ishin të përfaqësuara çështjet gjinore (të cilin do ta shqyrtojmë më tej), ndërsa në programin e kandidatës Vankovska nuk ishin të përfaqësuara çështjet gjinore dhe me këtë gjë vërtetohet se gjinia e kandidatit nuk ndikon domosdoshmërisht në (mos)përfaqësimin e çështjeve gjinore në programin zgjedhor, si edhe fakti që mundësitë e barabarta nuk duhet të jenë çështje për të cilat zotohen vetëm gratë.

E përderisa në programin e kandidatit të LSDM-së dhe të Koalicionit për Ardhmërinë evropiane ka seksione të veçanta për rininë, qytetarët e marginalizuar, personat me orientim seksual dhe me identitet tjetërfarë gjinor, si dhe personat me aftësi të kufizuara, një qasje të këtillë, të veçantë, nuk ka për çështjet e ndërlidhura me gratë.

Çështjet gjinore janë të përfaqësuara në masë të caktuar në programin e kandidatës së VMRO-DPMNE-së. Në disa pjesë të caktuara të programit vetëm përmendet koncepti gjinor, ndërsa në të tjerat janë përfshirë deri diku edhe masat

e përpunuara konkrete për arritjen e barazisë gjinore. Në program në masë të caktuar përdoret gjuhë e ndjeshme gjinore. Në pjesën e programit të kandidatës së VMRO-DPMNE-së që ka të bëjë me zgjidhjet e drejtpërdrejta të kuadrit lidhur me kabinetin e presidentes potenciale të ardhme përmendet dimensionin gjinor si një nga aspektet gjatë zgjedhjes së bashkëpunëtorëve. Në pjesën e programit Siguria, mbrojtja dhe NATO si projekt i veçantë është veçuar Qendra për përsosmëri të grave, të paqes dhe të sigurisë si një nga çështjet më të rëndësishme. Kjo qendër do të formohet me qëllim të promovimit të grave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në Maqedoni dhe në rajon, në bazë të njohurive teorike dhe praktike për rolin e grave në fushën e sigurisë. Ky projekt është shembull për zgjidhje konkrete me të cilën zbatohet politika e barazisë gjinore dhe përforcimi i pozitës së grave në fushën e sigurisë. Më tej, në pjesën Diplomacia jepet njoftimi i projektit për Profesionalizimin dhe barazinë gjinore në shërbimin diplomatik, edhe pse në kuadër të këtij projekti ka vetëm zotim për barazi në të gjitha bazat, por jo edhe masa konkrete lidhur me sigurimin e barazisë gjinore. Në pjesën Mbrojtëse e kategorive më të rrezikuara të qytetarëve përmendet mbështetja deklarative dhe zotimi për gratë rome, si pjesëtare të bashkësisë më të vogël etnike, veçanërisht për çështjen e papunësisë, për çështjet shëndetësore dhe sociale.

Kandidatja e VMRO-DPMNE-së e identifikon veten „si aktiviste dhe mbrojtëse e: të drejtave të grave, të drejtave të kategorive më të rrezikuara dhe drejtësisë sociale„.

Fragment nga programi zgjedhor Gordana Siljanovska- Davkova

03

Përfundime përmblyëse nga programet e kandidatëve për President

Nga ky vështrim i hollësishëm i programeve të kandidatëve për President mund të përfundohet se përfshirja e çështjeve multisektoriale, në përgjithësi është e pamjaftueshme. Kjo veçanërisht vlen për çështjet gjinore, të cilat përveç në programin e kandidatës së VMRO-DPMNE, nuk i hasim në asnjë nga programet e tjera të analizuar.

E dukshme është përpjekja e një pjese të kandidatëve për President që në programet e tyre të gjejnë vend për të rinjtë dhe çështjet lidhur me ta. Megjithatë, ky është vetëm fillimi dhe bazë e mirë që në të ardhmen kandidatët për President të përfshijnë sa më tepër çështje të këtilla në punën e tyre dhe ta operacionalizojnë këtë përmes veprimtimit të tyre.

Integrimi i çështjeve gjinore në kornizën kombëtare ligjore dhe institucionale është realitet, por duhet të forcohet implementimi i tyre në praktikë. Andaj, zotimet e kandidatëve për President për këto grupe të qytetarëve duhet të përforcohen dhe të shndërrohen në masa sa më konkrete, më tej përmes programit dhe masave të subjekteve politike që do të prezantohen në Qeverinë e re. Mesazhi dërgohet nga niveli më i lartë, nga pozita e Presidentit të shtetit, se çështjet që prekin të drejtat e grave dhe të rinjve duhet të përfshihen në agjendën e institucioneve, në shkallë shtetërore dhe në shkallë vendore, domethënë jepet një shembull se si ato duhet të zbatohen denjësisht përmes ndarjes së burimeve adekuate njerëzore dhe financiare.

Analiza e programeve zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare 2024 tregoi se në to janë përfaqësuar masa dhe politika që kanë të bëjnë me gratë. Te disa subjekte politike siç janë „Levica”, këto masa dhe politika janë përfshirë kryesisht në kuadër të fushave/sectorëve të posaçëm, ndërkaq te të tjerat, siç janë: VMRO-DPMNE, Koalicioni VLEN dhe Fronti evropian, janë veçuar kapituj të posaçëm që i përkushtohen grave. Kjo flet se subjektet politike, përpiqen të vendosin qasje strategjike për çështjet lidhur me gratë.

Te programet mbizotërojnë masat e ngjashme, ndërsa te subjektet politike, të cilat kanë numër më të madh përfaqësuesish në Kuvend, është i pranishëm një spektër i gjerë masash dhe politikash të fushave të ndryshme. Por, çështjet kyçe për gratë siç janë arsimi, punësimi, standardi dhe shëndetësia, mbështetja ekonomike dhe punësimi, si dhe masat sociale, janë të pranishme te të gjitha subjektet politike. Gjithashtu, në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare mund të vërehen masa të cilat tashmë janë të pranishme ose janë duke u zbatuar, si dhe masa krejtësisht të reja ose shfuqizime të disa masave ekzistuese. Në vazhdim vijon analiza e hollësishme për përfshirjen e çështjen grave në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare.

Përfshirja dhe trajtimi i çështjeve gjinore Fokus politikat për çështjet gjinore

Siç u theksua më lart, çështjet gjinore gjejnë vendin e vet në programet zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Për fat të keq, përfshirja e këtillë është mjaft e kufizuar te pjesa më e madhe e subjekteve politike pa integrim të mirëfilltë të masave dhe politikave në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Përjashtim bëjnë partitë politike që kanë numër më të madh përfaqësuesish në Kuvend, ku edhe pse jo aq thellësisht, megjithatë ekziston një nivel i caktuar integrimi të politikave për gratë në gjithë programin.

Pasqyra e përfshirjes së çështjeve gjinore është e ndarë në dy pjesë:

- Fokus politikat për çështje gjinore përkushtuar politikave për çështje gjinore në të cilin përpunohen të gjitha masat nga programet zgjedhore të subjekteve politike të cilat japin fokus të politikave për çështje gjinore,

dhe


- Politikat ndërsektoriale për çështje gjinore ku jepet përmbledhja e të gjitha masave tjera gjinore të përfaqësuar në fusha të ndryshme tematike në programet zgjedhore të subjekteve politike.


Programi Plani 2030 i Koalicionit VLEN, programi Evropa 2030 i Frontit Evropian nuk përmbajnë kapituj të posaçëm ose segmente për gratë dhe çështjet gjinore, për atë arsye ato masa janë prezantuar vetëm në pjesën politikave ndërsektoriale për çështjet gjinore.

Platforma # 1198 të VMRO-DPMNE-së

Në platformën # 1198 të VMRO-DPMNE-së fokus të çështjeve gjinore ka në kapitullin VI. Të drejtat dhe liritë, segmenti programor Gruaja-qendër e shoqërisë maqedonase.


Ky segment programor përfshin shumë aspekte si më poshtë:


 Kundër dhunës ndaj grave – si masa që veçohen në këtë aspekt janë: hapja e dhjetë qendrave të reja për kujdesje dhe mbështetje të grave viktime të dhunës në bazë gjinore, licencimi i ofruesve të shërbimeve për shërbime të specializuara për dhunë në bazë gjinore, si dhe formimi i ekipeve komunale multisektoriale të cilat veprojnë sipas modelit të paraparë për paraqitjen e rasteve të formave të ndryshme të dhunës. Gjithashtu, parashikohet edhe forcimi i kapaciteteve të profesionistëve që u ofrojnë shërbime viktimave të dhunës. Më tej, si pjesë e veçantë për luftën kundër dhunës përpunohet tejkalmimi i problemit me dhunën në shkolla përmes programeve të reja për këshillimin e fëmijëve dhe prindërve si edhe procedurat e reja për veprim.

 Mbështetja e gruas në familje ku janë paraparë masat stimuluese për lehonat, si për shembull mbështetje për punëdhënësit të cilët e kanë aprovuar punën fleksibile nga shtëpia që u mundëson grave t'i përshtatin obligimet e tyre familjare dhe të punës, si dhe masa të posaçme për gratë shtatzëne dhe lehona që kanë të bëjnë me mbështetjen psikologjike të grave gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes.

Segmenti Gruaja-qendër për shoqërinë maqedonase fillon me tezën: „Barazia e grave dhe e burrave është e drejtë themelore e njeriut, element thelbësor i demokracisë dhe imperativ i drejtësisë sociale“.


Fragment nga programi zgjedhor Platforma # 1198 e VMRO-DPMNE-së


 Forcimi i pavarësisë ekonomike të grave ku si masa të posaçme veçohen rroga të barabarta për gratë dhe meshkujt, më tej përmirësimi i kushteve për gratë fermere përmes zgjidhjes sistemore me të cilën gratë fermere do të mund ta realizojnë të drejtën e pensionit dhe pushimin e lindjes, realizimi i kurseve për trajnime dhe trajnime shtesë, mbështetja e nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe arsim me qasje për të gjitha vajzat për të cilat thuhet: „t'i përfshijmë tërësisht në procesin arsimor edhe ato vajza të reja të cilat ende nuk janë pjesë e tij. Vajzave të reja do t'u sigurojmë këshillim karriere në shkolla.“

 Shëndetësia maqedonase-mbështetëse e grave, në të cilën parashihet „mbrojtje shëndetësore të arritshme, efikase, parandaluese me qëllim të parandalimit të sëmundjeve malinje te gratë , e drejta e qasjes në shërbimet adekuate shëndetësore të cilat grave do t'u mundësojnë shtatzëni dhe lindje të sigurt, ndërsa çifteve do t'ua japin mundësinë të kenë foshnje të shëndetshme.“ Gjithashtu, përpunohet edhe avancimi i shëndetit reproduktiv te gratë.

Programi për Ardhmërinë evropiane 2024 i LSDM-së dhe Koalicionit për ardhmëri evropiane

Në këtë program, fokusi i politikave për barazi gjinore është në kapitullin IV. Cilësi evropiane e jetesës, gjegjësisht, në këtë kapitull theksohet se „Barazia gjinore mbetet imperativi ynë politik, sepse secila është e vlefshme dhe meriton të respektohet barabarësisht, të dëgjohet, të konsiderohet, të mbrohet dhe të paguhet institucionalisht.“ Më tej çështjet gjinore janë prezantuar si më poshtë:


 Pjesa më e madhe e barazisë gjinore përfshin zotime për realizimin e barazisë gjinore dhe një sërë masash konkrete përmes së cilave do të realizohej: Ligji i ri për barazinë gjinore, me të cilin parashihet themelimi i Sekretariatit për barazi gjinore, në Kodin Zgjedhor të ri të vendoset pariteti d.m.th. parimi 50% - 50% nga ty dyja gjinitë në listat e deputetëve dhe këshilltarëve në komuna dhe në Qytetin e Shkupit, dhe të obligueshme 30% gra kandidatë për kryetare të komunave. Më tej, parashihet që të avancohet mbrojtja ligjore e punonjëseve shtatzëne ndërkohë që do të rregullohej në mënyrë sistematike pushimi i lindjes së grave fermere, vendosja e politikës për dhënien e bursave për vajza në STEM (Science, Technology, Engineering and Mathematics), përfshirje e rritur e grave me kontrole parandaluese të parapara me Programin e hetimit të hershëm të sëmurjeve malinje dhe mbështetje më e madhe për pjesëmarrjen e grave në programet për mbështetje financiare në bujqësi. Barazia gjinore planifikohet të inkorporohet në të gjitha programet mësimore.


 Në kapitullin VII. Rinia shtyllë e së ardhmes është prezantuar Manifesti rinor në të cilin janë paraqitur zotimet e të rinjve për periudhën vijuese, e në mesin e tyre janë përfshirë zotime për barazinë gjinore në pjesën Barazi dhe përfshirje për ty. Dhe për të gjithë. Zotimet përfshijnë: barazinë gjinore, jetën e çliruar nga dhuna për çdonjeri përmes kornizës ligjore adekuate, shërbimet e arritshme për mbështetje, parandalim dhe edukim, mundësitë e barabarta në tregun e punës përmes zvogëlimit të hendekut gjinor në rroga dhe vendosjen e ekonomisë së kujdesit, përfaqësimit e barabartë të grave në pozitë vendimmarrëse, deri në 50-50% në parlament dhe 40% kuota për gjininë më pak të përfaqësuar në të gjitha pozitë, shëndetin seksual dhe reprodutiv dhe të drejtat përmes edukimit, mbrojtjes dhe parandalimit të vajzave të reja dhe grave, të drejtat e gruas rome dhe integrimin e saj të plotë, përfshirjen dhe arsimin e arritshëm.

Programi Të pakorruptueshmërit në Kuvend i Levicës

Në programin Të pakorruptueshmërit në Kuvend të Levicës fokus të çështjeve gjinore ka në kapitullin I. Puna dhe drejtësia sociale, segmenti për Çështjet gjinore dhe barazinë gjinore.

Në kuadër të këtij segmenti përmenden disa zotime dhe masa që kanë të bëjnë me sigurimin e barazisë gjinore dhe vendin më të mirë të gruas në shoqëri:

 Zotimi kryesor ka të bëjë me promovimin e feminizmit të majtë dhe avancimin e të drejtave të gruas „përmes tejkalimit të moralit patriarkal, prapambetjes kulturore dhe qëndrimeve mizogjene“. Gjithashtu, si zotim përmendet edhe njohja e punës së padukshme dhe kujdesi për familjen.

 Si masa konkrete për mbështetjen e amësisë të gratë punonjëse parashikohet dyfishimi i pushimit të lindjes, orari fleksibil i punës ose i shkurtuar në periudhë prej tre vjetësh pas lindjes, kthimi në vendin e njëjtes të punës në të cilin ka qenë punonjësjë para pushimit të lindjes dhe vendosja e pushimit të lindjes me pagesë për gratë fermere.

Vetëm në programin zgjedhor të Levicës parashihet masa për tejkalimin e varfërisë menstruale përmes sigurimit të mundësisë për pushim menstrual të papaguar dhe lehtësime tatimore për prodhime që janë të dobishme për higjienën menstruale dhe shëndetin reprodutiv.

Politika ndërsektorale për çështje gjinore

Në segmentet tjera programore të **Platformës # 1198 të VMRO-DPMNE-së**, politikat për gratë janë përfshirë në:

○ Kapitulli I. Lufta për standard cilësor jetësor, gjegjësisht:

Në kuadër të Planit kombëtar për demografi për nënat që janë të punësuararashikohet mbështetje plotësuese financiare pas mbarimit të pushimit të lindjes në llojin e kthimit të tatimit të paguar të të ardhurave personale për çdo fëmijë të lindur. Gjithashtu parashikohet edhe mbështetja për kompanitë punëdhënëse të grave si lirim nga pagesa e kontributeve të sigurimit të detyruar shëndetësor edhe në rastet e papunësisë, si edhe tatimin e të ardhurave personale në periudhë trevjeçare llogaritur nga dita e punësimit, me detyrimin e punëdhënësit ta mbajë nënën në vendin e punës aq vite sa përdoret kjo masë. Janë paraparë deri në gjashtë (6) fekondime falas in vitro pa marrë parasysh gjendjen e pasurisë apo numrin e fëmijëve që i ka gruaja.

Në segmentin programor Bujqësia dhe ushqimi për Maqedoninë, në aspektin Zhvillimi i mjediseve rurale parashihen projekte për mbështetjen e grave fermere.

○ Kapitulli IV. Sistem funksional për qytetarët, në segmentin programor Do të ketë sistem shëndetësor cilësor, është paraparë një aspekt i veçantë Kujdesi për shëndetin e grave përmes ngritjes së vetëdijes për shëndetin e grave dhe hapjen e qendrës së posaçme për fekondimin in vitro në kuadër të Klinikës universitare për gjinekologji dhe akusheri.

○ Kapitulli V. Patriotizmi që bashkon parasheh:

Në segmentin Siguria dhe Mbrojtja, Forcimi i rolit të gruas në strukturat e sigurisë në polici përmes përfaqësimit të barabartë të grave në pozita udhëheqëse në polici.

Në segmentin Sporti krenari kombëtare parashikohet aspekti i veçantë Gruaja në sport, ku parashikohet të vihet theksi në rritjen e përfshirjes së grave dhe vajzave në sportin profesional dhe rekreativ, si dhe në mbështetjen plotësuese financiare për klubet sportive që do ta mundësojnë këtë dhe promovimin e vazhdueshëm të sportit femëror dhe të rezultateve të realizuara sportive.

Në kapitujt tjerë të Programit për ardhmërinë evropiane 2024të LSDM-së dhe të Koalicionit për Ardhmëri evropiane politikat dhe masat për gratë dhe çështjet gjinore hasen në:

○ Kapitulli I. Energji e re ekonomike për zhvillim dhe standard evropian parasheh mbështetje financiare për gratë fermere në lloje të granteve deri në 6.000 EUR dhe rritjen e grantit deri në 10.000 EUR. Më tej:

Në segmentin 1. Maqedonia në tregun evropian theksohet zotimi për pjesëmarrje të barabartë të grave d.m.th. ,Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe grupeve të rrezikuara në aktivitetet ekonomike ka rëndësi thelbësore për arritjen e barazisë sociale dhe zhvillimit gjithëpërfshirës“, ndërkohë pa u përmendur masat konkrete se si do të rritet pjesëmarrja.

Në segmentin 4. Shija e Maqedonisë parashihet zmadhimi i Programit për amësi 2024 në 100.000 MKD si kompensim për pushimin e lindjes prej 9 muajve dhe deri në vitin 2027 rritje deri në 150.000.

○ Në kapitullin III. Kujdes për të gjithë, hasen masa në:

Segmentin 1. Më tepër dhe më mirë për të gjithë parashikohet masa për nxitjen e barazisë gjinore përmes forcimit ekonomik dhe pavarësisë së grave. Që të motivohet sektori privat për punësimin e grave planifikohet formimi i fondit mbështetës – lirim prej kontributeve në afat 12 – muajsh për punësimin e grave të papunësuar për një kohë më të gjatë, shfrytëzuese të GMP-së dhe gratë viktime të dhunës familjare dhe në bazë gjinore.

Segmenti 2. Standarde evropiane për shëndetësinë maqedonase në pjesën e mbrojtjes parësore shëndetësore parashihet plotësimi i skriningut mamografik.

○ Në kapitullin V. Maqedoni e sigurt janë paraqitur zotime për sigurimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Ndërkohë theksohen zotimet për implementimin e barazisë gjinore në nivelin e ligjeve, strategjive dhe ngjash. Dhe vazhdimin e aktiviteteve të nisura për përmirësimin e barazisë gjinore, por përveç përmendjes së masave deri tani të ndërmarra për ngritjen e barazisë gjinore (siç janë zero toleranca në Armatë për shqetësim seksual, mbrojtje nga ngacmimet në vendin e punës, zbatimi i konceptit për buxhet të përgjegjshëm gjinor në Armatë e ngjash.) nuk përmenden masa të reja ose projekte.

○ Në kapitullin IV. Cilësi evropiane e jetesës, pjesa 4. Sport për një jetë të shëndetshme theksohet se vazhdojnë aktivitetet për forcimin e barazisë gjinore në sport deri në 50% përfshirje të grave në strukturat drejtuese të klubeve dhe federatave. Në këtë rast theksohet edhe zotimi që federatat dhe klubet të cilat pranojnë mbështetje financiare shtetërore të mundësojnë funksionim e sportit mashkullor dhe femëror.

Në programin **Evropa 2030 i Frontit Evropian** masat për çështjet gjinore janë përfshirë në kapitujt dhe segmentet vijuese:

○ Kapitulli I. Një kryeministër për të gjithë, segmenti 1.1 Qeverisja e mirë, është definuar zotimi Pjesëmarrja sipas së cilit është paraparë gratë dhe burrat duhet të kenë pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje ndërsa procesi i pjesëmarrjes duhet të organizohet në atë mënyrë që të ofrojë qasje të barabartë dhe transparente në informimin e burrave dhe grave.

○ Në kapitullin 3 Marrëveshje e konsensusit ekonomik është përfshirë zotimi Mundësi të barabarta për të gjithë në të cilin përfshihet pjesëmarrja e barabartë në ekonomi për të gjithë, duke përfshirë edhe në bazë gjinore. Në këtë kapitull gjithashtu janë përfshirë këto masa: Në segmentin Zhvillim i qëndrueshëm dhe transformim i gjelbër, pjesa Zhvillimi rural dhe agrar, parasheh mbështetje për gratë në bujqësi përmes subvencionimit të mjeteve të pakthyeshme në lloj të grantit prej 6.000 euro, si dhe dhënia përparësi grave në furnizimin e makinerisë.

Segmenti Zhvillimi i barabartë rajonal parasheh stimuj dhe programe të veçanta për punësimin dhe themelimin e sipërmarrjeve nga gratë, lirim nga tatimet, vendosjen e statistikave mbi sipërmarrjen e grave, trajnime për gra. Parashikohet edhe Ligji për mbështetjen e sipërmarrjeve sociale për t'u dalë në ndihmë grave dhe të rinjve në themelimin e këtyre sipërmarrjeve, formalizmin e punësimit joformal te gratë, dhe uljen e dallimeve në shkallën e punësimit te burrat dhe gratë.

Zotim: „Përmirësimi i qasjes së gruas në kujdesin shëndetësor dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, veçanërisht në vendbanimet rurale“.

Fragment nga programi zgjedhor Evropa 2030 i Frontit Evropian

Si masë e veçantë është Sigurimi i shkallës më të lartë të barazisë gjinore në rajonet planifikuese përmes: përmirësimit të praktikave për përcaktimin e çështjeve gjinore, forcimin e kapaciteteve të barazisë gjinore të anëtarëve të këshillave komunalë, Komisionit për mundësi të barabarta (KMB) dhe Komisionit për mbrojtje sociale, shëndetësore të fëmijëve, mbledhjes sistematike të të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe analiza e tyre nga aspekti gjinor dhe rritjes së përfshirjes së fëmijëve në kopshte, krijimit të mundësive për aktivizimin e tregut të punës për prindërit, veçanërisht për nënat.

Në segmentin Rini aktive dhe shoqëri e barabartë, në pjesën 3.5.4 Sport dhe rekreacion, parashihet Avancimi i barazisë gjinore në sport përmes programeve dhe turneve për vajzat dhe gratë, përmes së cilave ato do të kenë mundësi të barabarta për t'i zhvilluar shkathtësitë e tyre sportive, promovimin e trajnereve dhe drejtueseve të femrave në sport, mbështetje domethënëse të klubeve sportive, klubeve të specializuara për gra dhe vajza. Në pjesën 3.5.6 Familja bërthama e shoqërisë në mënyrë indirekte parashikohen edhe masa për forcimin e pozitës së gruas në shoqëri, përkatësisht pushimin familjar me pagesë, duke përfshirë pushimin e lehonisë dhe atësisë, dhe qasje në kujdesin shëndetësor për të gjithë anëtarët e familjes.

Koalicioni VLEN në programine tij **Plani 2030** i parasheh këto masa gjinore:

- Kapitulli VII. Mirëqenia dhe ekonomia parasheh, ngjashëm si dhe koalicioni për ardhmërinë evropiane, vendosjen e Kuotës 40% gra respektivisht përfshirjen e grave në 40% në të gjitha nivelet. Parashikohet diskriminimi pozitiv për pozitat e punës të cilat plotësohen me anë të konkursit dhe në rast të poenëve të barabartë do të favorizohet gjinia më pak e përfaqësuar në atë vend pune dhe uljen e tatimit në fitim për bizneset të cilat do të punësojnë vajza të reja dhe gra.

Levica në programin e saj Të pakorruptueshmit në Kuvend ka përfshirë disa masa gjinore përgjatë programit:

- Kapitulli XII. Siguria publike dhe mbrojtja popullore në segmentin Policia parasheh formimin e një departamenti të posaçëm për trajtimin e rasteve të dhunës familjare, të veprave penale me bazë gjinore/seksuale.

Më tej, në kapitujt e tjerë parashikohen masa për mbështetjen e vetëpunësimit përmes qasjes së kredive pa interes dhe grejs periudhës së shlyerjes së kredive për gratë zeytare dhe gratë e falimentuara.

Analiza e gjerë e programeve zgjedhore të partive politike dhe të koalicioneve për zgjedhjet parlamentare tregon se përfshirja e çështjeve gjinore është e vëllimshme.

Pothuajse në të gjitha programet zgjedhore masat e propozuara nuk janë mbështetur me afatet kohore për zbatimin e tyre dhe nuk janë propozuar treguesit përmes së cilëve do të ndiqej zbatimi i tyre. Për shkak të kësaj, është pothuajse e pamundur të vlerësohet vallë masat e propozuara janë të realizueshme dhe çfarë lloji dhe vëllimi të burimeve njerëzore dhe financiare nevojiten për zbatimin e programeve.

Çështjet gjinore

Analiza më e thelluar tregoi se përfshirja e çështjeve gjinore është sipërfaqësore dhe kryesisht ka të bëjë me sigurimin e mbështetjes së grave me qëllim që ato të bëhen më të pavarura ekonomikisht, por edhe të jenë më të afrueshme dhe më fleksibile si shtyllë e familjes gjë që jo gjithmonë çon në barazi gjinore. Më tej, politikat dhe masat për gratë të cilat janë prezantuar në programet zgjedhore kryesisht janë mjaft të ngjashme, e veçanërisht ato që kanë të bëjnë me gratë fermere ku masë kryesore është që t'u sigurohet pushimi i lindjes me pagesë – diçka që si masë veçmë është iniciuar. Masat tjera kanë të bëjnë me mbështetjen financiare dhe grantet për projektet të cilat do të nxisin angazhimin e grave fermere në zhvillimin rural. Ajo që vërehet është se mbështetja e planifikuar për gratë fermere nuk shkon një hapë më tej d.m.th. nuk janë paraparë masat të cilat do t'i shkarkonin gratë fermerë nga obligimet ekzistuese në shtëpi në llogari të angazhimit të tyre në bujqësi.

Në programet zgjedhore, gjithashtu, janë përfshirë edhe masa të cilat nënkuptojnë vazhdimin e disa zotimeve të mëparshme, si për shembull masat për reduktimin e dhunës familjare ndaj grave, ofrimin e mbështetjes për gratë të cilat janë viktimat të dhunës familjare dhe dhunës në bazë gjinore, si dhe masat për kontrollë mjekësore pa pagesë dhe skringing mamografik për gratë. Shumë më të rralla janë masat për përforcimin e rolit të Komisioneve për mundësi të barabarta (KMB) dhe Koordinatorëve për mundësi të barabarta (KMB Koordinatorët) të cilat janë krijuar në kuadër të vetëqeverisjeve vendore dhe më këtë gjë lëshohet mundësia për përforcimin e mëtejshëm të perspektivës gjinore (përmes KMB-së dhe Koordinatorëve) në zhvillimin e politikave publike dhe dhënies së shërbimeve në shkallë vendore.

Janë interesante zotimet në fushën e sportit ku pothuajse të gjitha subjektet politike zotohen për barazi më të madhe të grave në sport. Një pjesë e subjekteve politike shkojnë edhe më tutje përmes propozimit të masave konkrete për përforcimin e pozitës dhe numrit të grave në trupat udhëheqës të federatave dhe klubeve, si dhe mbështetje më të madhe të klubeve të grave dhe sportit të grave. Fatkeqësisht, në asnjërën nga programet e analizuara nuk ishin propozuar masat përmes të cilave do të ishte rritur pjesëmarrja e grave në të ashtuquajturat „sporte jotipike femërore“ si për shembull futbollin dhe/ose boksin dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohet hendeku i pjesëmarrjes së grave në „sportet tipike femërore“ dhe mospjesëmarrjes së grave në „sportet tipike mashkullore.“

Në programet zgjedhore për këtë cikël të zgjedhjeve zënë vend dominues edhe zotimet dhe masat për zvogëlimin e hendekut të rrogave ndërmjet burrave dhe grave, si dhe masat për sigurimin e përfshirjes së barabartë të gjinive në vendet e punës në administratë. Zotimet dhe masat konkrete për kuotat e grave në politikë dhe në pozitat drejtuese gjithashtu janë përfshirë në pjesën më të madhe të programeve zgjedhore. Ashtu si në programet e mëparshme zgjedhore, edhe tani me vënien e një mase të tillë supozohet/pritet që rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në këshilla të rezultojë me politika të ndjeshme (sensitive) gjinore dhe shërbime . Për fat të keq, praktika e deritashme në botë, por edhe në vend, vërteton se rritja e numrit të grave është vetëm hapi i parë dhe baza e ndryshimeve thelbësore d.m.th. rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në pozitat drejtuese nuk është një qëllim vetë për vete. Barazia gjinore dhe mundësitë e barabarta arrihen me ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, të atyre që tashmë janë të përfshirë. Ky lloj masash nuk ishin propozuar në programet e analizuara.

Si plotësim, është interesante të përmendet se në programet zgjedhore njihet edhe rëndësia e përfshirjes aktive të grave në sistemin e sigurisë së shtetit - përmes perspektivave të ndryshme. Te disa subjekte politike kjo domethënë përsëritje e masave dhe aktiviteteve tanimë të ndërmarra, ndërsa te të tjerat ka edhe zotime të reja për një rol më sistematik të grave, si për shembull themelimi i subjekteve të posaçme që do të kenë në fokus vendin e gruas në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në fund, mund të konstatohet se zotimet për gratë e bashkësive më të vogla etnike janë të pakta. Mund të gjenden vetëm zotime për përfshirjen e grave rome në pjesën e arsimit, punësimit dhe shëndetësisë, por megjithatë mungojnë masa më konkrete, as që ka ndonjë qasje të propozuar se si të përfshihen gratë e bashkësive më të vogla etnike.

Është mjaft e rëndësishme të njihen nga afër qytetarët me përfshirjen e çështjeve gjinore në kuadër të programeve zgjedhore. Në këtë mënyrë, edhe ata do të mund në mënyrë të pavarur ose me mbështetjen e sektorit qytetar të kërkojnë llogaridhënie më të madhe nga autoritetet e nivelit kombëtar dhe vendor.

Megjithëse përfshirja e masave që kanë të bëjnë me çështjet gjinore mund të jetë më e thelluar dhe më strategjike, megjithatë edhe për këto masa të përfshira me rëndësi është që ato të jenë të operacionalizuara në programe konkrete, që të përfshijnë edhe projeksione financiare edhe buxhet të nevojshëm për realizim, si dhe burime prej nga do të sigurohen mjetet financiare.

Duke pasur parasysh ekzistimin e një numri të madh prioritetesh të qeverisë dhe tendencën për marginalizimin e çështjeve për barazi gjinore, është mjaft e rëndësishme të ketë zotim dhe lobim aktiv për këto masa nga sektori qytetar dhe qytetarët për zbatimin e masave përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së qeverisë.

Është i nevojshëm zhvillimi i dialogut dhe diskutimit publik rreth operacionalizimit të masave për gratë që janë zhvendosur në programet zgjedhore të subjekteve politike. Diskutimi i këtillë publik duhet veçanërisht duhet të ofrojë mundësi për përfaqësim të barabartë të nevojave dhe zgjidhjeve në baza rajonale, etnike dhe gjinore.

Përfshirja e çështjeve gjinore në programet zgjedhore, të cilat konkretisht i referohen bashkësive më të vogla etnike, duhet të jetë më e madhe dhe të përfshijë më shumë masa dhe qasje për trajtimin e nevojave të këtyre bashkësive.

Analiza e programeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2024 të subjekteve politike të cilat tani e përbëjnë Qeverinë (VMRO-DPMNE, Koalicioni „Vlen” dhe Lëvizja Znam) tregoi se në to u përfaqësuan masat dhe politikat që kanë të bëjnë me çështjet rinore. Kjo tregon se subjektet politike premtuan edhe një qasje më strategjike ndaj çështjeve rinore dhe çështjeve të ndërlidhura me gratë.

Kjo analizë krahasimtare ka për qëllim të hulumtojë në ç ‘vëllim masat e premtuara në fushën e çështjeve gjinore dhe fuqizimi i grave, të cilat ishin pjesë e programeve zgjedhore të partive aktualisht në qeveri, janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028. Më konkretisht analiza do të përfshijë paraqitjen e shkurtër të premtimeve në:

- Programin zgjedhor të VMRO-DPMNE-së „Platforma # 1198”.
- Programin zgjedhor të Koalicionit „Vlen“ „Plani 2030”.
- Programin zgjedhor të Lëvizjes Znam „Manifest për Maqedoni të denjë”.

Analiza krahasimore e përfshirjes dhe trajtimit të çështjeve gjinore

Analiza e çështjeve gjinore në programet zgjedhore të subjekteve politike VMRO-DPMNE dhe Koalicioni „Vlen” të cilat tani janë pjesë e Qeverisë, tregoi se përfshirja e tyre është e kufizuar, gjegjësisht mungon integrimi i thelluar të masave dhe politikave gjinore nëpër të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet e programeve.

Në programin zgjedhor të Lëvizjes Znam këto çështje nuk u trajtuan aspak, prandaj në analizën e mëtejme është paraqitur krahasimi i premtimeve për çështjet gjinore të parapara në programet zgjedhore të VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit „Vlen” kundrejt masave të përfshira në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

Zotimet dhe masat nga platforma #1198 – gjetjet kryesore

Kapitulli VI. të drejtat dhe liritë – fokus programor gruaja qendër e shoqërisë maqedonase

Në Platformën #1198 të VMRO-DPMNE-së fokusi i çështjeve gjinore ishte dhënë në kapitullin VI. Të drejtat dhe liritë, segmenti programor Gruaja-qendër e shoqërisë maqedonase. Ky fokus është ruajtur në mënyrë të njëjtë edhe në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028, por njësitë që mbuluan tema të ndryshme në kuadër të Platformës #1198, në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 nuk janë ndarë me nëntituj të veçantë.

Nga gjithsej 4 njësi me premtime në segmentin programor Gruaja-qendër e shoqërisë maqedonase (kundër dhunës familjare, mbështetjes së gruas në familje, pavarësisë ekonomike dhe shëndetësisë) në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 janë paraparë zotime dhe masa të cilat i referohen 3 njësive. Njësia e katërt, gruaja në familje , e cila është përfshirë në Platformën #1198 pothuajse nuk është përfshirë aspak në Programin e punës së Qeverisë, gjegjësisht janë ndërmarrë një pjesë masash për fleksibilitet gjatë punësimit, por ato masa nuk janë ekskluzivisht për gratë.

Në njësinë shëndetësia edhe pse janë përfshirë premtimet parazgjedhore nga Platforma #1198, megjithatë në Programin e punës së Qeverisë nuk ka masa konkrete si do të realizohen zotimet.

Tabelë Krahasimore 1- Krahasimi i Platformës #1198, segmenti programor Gruaja-qendër e shoqërisë maqedonase me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Kundër dhunës ndaj grave - hapja e dhjetë qendrave të reja për kujdesin dhe mbështetjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore, licencimi i ofruesve të shërbimeve për shërbime të specializuara për dhunën me bazë gjinore, si dhe formimi i ekipeve multisektoriale komunale që veprojnë sipas modelit të paraparë për paraqitjen e rasteve të ndryshme të dhunës. Gjithashtu, parashikohet përforcimi i kapaciteteve të profesionistëve që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës. Më tej, si pjesë e veçantë për luftën kundër dhunës përpunohet tejkalimi i problemit të dhunës në shkollat përmes programeve të reja për këshillimin e fëmijëve dhe prindërve, si dhe procedurat e reja të veprimit.

Shëndetësia maqedonase - mbështetëse e grave, në të cilin parashikohet „mbrojtje shëndetësore e arritshme, efikase dhe parandaluese me qëllim të parandalimit të sëmundjeve malinje te gratë, të drejtat e qasjes së shërbimeve adekuate shëndetësore që grave do t'u mundësojnë shtatzëni dhe lindje të sigurt, ndërsa çifteve do t'ua ofrojnë mundësinë të kenë foshnje të shëndetshme.“ Gjithashtu, përpunohet edhe avancimi i shëndetit reprodutiv te gratë.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Zotime:

- Zero tolerancë për format e ndryshme të dhunës të cilave u ekspozohen gratë.
- Përmirësimi i qasjes në shërbimet e specializuara për mbështetjen e gjitha grave dhe fëmijëve të tyre, rritja e numrit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për mbështetje.

Masa:

- Do të hapen dhjetë qendra të reja për kujdesin dhe mbështetjen e grave, viktime të dhunës në bazë gjinore
- Grup ndërinstytucional i Qeverisë që do të punojë në luftën kundër dhunës ndaj gruas përmes përforcimit të rregullativës ligjore, përmes koordinimit më të fuqishëm dhe të rregullt të institucioneve shtetërore dhe lokale dhe organizatave joqeveritare, si dhe përmes implementimit të denjë të marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare, konventave dhe rezolutave për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjes së dhunës ndaj grave.

Zotime:

- Veçanërisht do të zotohemi për qasje në mbrojtje cilësore shëndetësore, posaçërisht te grupet sociale të rrezikuara të popullatës për HIV/SIDË dhe infeksione tjera seksualisht të transmetueshme, për sëmundjet malinje të gjirit dhe të mitrës.
- Do të sigurohet mbrojtje shëndetësore e arritshme, efikase e parandaluese me qëllim të parandalimit të sëmundjeve malinje te gratë.
- Të drejtat e qasjes në shërbime adekuate shëndetësore që do t'u mundësojnë grave shtatzëni dhe lindje të sigurt, ndërsa çifteve do t'ua ofrojnë mundësinë të kenë foshnje të shëndetshme.

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Përforcimi i pavarësisë ekonomike të grave ku si masa të veçanta veçohen pagat e barabarta për gratë dhe burrat, më tej përmirësimi i kushteve për gratë fermere përmes zgjidhjes sistemore me të cilën gratë fermere do të mund ta realizojnë të drejtën e pensionit dhe pushimin e lindjes, realizimi i kurseve për parakualifikim dhe rikualifikim, mbështetja e nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe arsim të arritshëm për të gjitha vajzat për të cilat thuhet: „do t'i përfshijmë tërësisht në procesin arsimor edhe ato vajza të reja të cilat ende nuk janë pjesë e tij. Vajzave të reja do t'u mundësojmë këshillime karriere në shkolla.“

Mbështetja e gruas në familje ku janë parashikuar masa stimuluese për lehonat, si për shembull mbështetja për punëdhënësit që kanë vënë në përdorim punën fleksibile nga shtëpia e cila u mundëson grave t'i harmonizojnë obligimet e tyre familjare dhe të punës, si dhe masa të veçanta për gratë shtatzëne dhe lehona që kanë të bëjnë me mbështetjen psikologjike të grave gjatë tërë shtatzënisë dhe pas lindjes.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Zotime:

·Grupi ndërinstitucional i Qeverisë do të punojë në masat për t'i përfshirë tërësisht në procesin arsimor edhe ato vajza të reja të cilat ende nuk janë pjesë e tij.

Masa:

·Përmes dialogut social do të punohet në uljen e dallimeve në paga ndërmjet burrave dhe grave, përmes krijimit të planit neutral për klasifikimin e profesioneve të cilat dominohen nga punonjëset.

Institucionet do të zhvillojnë plane dhe programe në kuadër të aktiviteteve të Agjencisë së Punësimit për përfshirjen më të madhe të grave nga zonat urbane dhe rurale në tregun e punës, përgatitjen e programeve vjetore për sipërmarrjen femërore dhe rritjen e vazhdueshme të buxheteve për këtë synim në shkallë vjetore.

Masa (në segmentin programor Vende produktive pune dhe me cilësi të lartë):

Fleksibilitet më i madh i orarit të punës te prindërit e rinj në vitet e para prindërore (punë nga shtëpia, fleksibilitet në shfrytëzimin e orëve të punës gjatë javës në përputhje me rregullimin e punës së punëdhënësit).

Politika ndërsektoriale për çështje gjinore

Në **Platformën #1198 të VMRO-DPMNE-së** një pjesë të politikave ndërsektoriale për çështje gjinore ishin prezantuar në Kapitullin I. Lufta për standard cilësor jetësor, që në Programin e punës së Qeverisë tani është Kapitulli I. Standard cilësor jetësor–Cikël i ri i rritjes ekonomike, dhe në këtë rast i përfshin zotimet dhe masat e njëjta të premtuara. Si plotësim, masat për mbështetjen e nënave si dhe firmave që punësojnë nëna janë saktësuar në mënyrë plotësuese.

Në kuadër të Platformës I, si në programin zgjedhor, ashtu edhe në Programin e punës së Qeverisë është përfshirë një segment i veçantë programor për bujqësinë që quhet Bujqësia e Zhvilluar. Premtimi nga Platforma #1198 për mbështetjen e projekteve për gratë në vendbanimet rurale është përfshirë edhe në Programin e punës së Qeverisë në segmentin Bujqësi e zhvilluar, në të njëjtën mënyrë, me qëllim të uljes së shpërnguljes në vendbanimet rurale, por pa ndonjë saktësim të veçantë se për çfarë projektsh bëhet fjalë.

- Kapitulli IV. Sistemi funksional për qytetarët në Programin e punës së Qeverisë emërtohet si Sistemi institucional funksional. Në kuadër të këtij kapitulli në segmentin programor Sistemi cilësor jetësor në të njëjtën mënyrë është përfshirë premtimi për formimin e qendrës për fekondim in vitro në kuadër të Klinikës universitare për gjinekologji dhe akusherë, por jo edhe zotime dhe masa për ngritjen e vetëdijes për shëndetin e grave.
- Kapitulli V. Patriotizmi që bashkon, në Programin e punës së Qeverisë emërtohet si Prioritetet kombëtare. Në segmentin programor Siguria dhe Mbrojtja është përfshirë zotimi përfaqësimi i grave në strukturat e sigurisë. Zotimi i këtillë parasheh “përfaqësim adekuat të grave në strukturat e sigurisë”, ndërkaq në programin zgjedhor bëhej fjalë për premtimin për “përfaqësimin e barabartë të grave në pozitat drejtuese. Gjithashtu, nuk ka masa konkrete si do të arrihet kjo. Në segmentin programor Sporti krenari kombëtare në Programin e punës së Qeverisë nuk ka zotime dhe masa për gratë dhe çështjet gjinore, edhe pse në Platformën #1198 kishte premtime në temën Gruaja në sport.

Tabela Krahasimore 2- Krahasimi i Platformës #1198, politikat multisektoriale me Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028

Platforma # 1198 (premtime zgjedhore)

Kapitulli I. Lufta për standard cilësor jetësor:

-Në kuadër të **Planit kombëtar** për demografi për nënat që janë të punësuara parashihet mbështetje plotësuese financiare pas mbarimit të pushimit të lindjes në llojin e kthimit të tatimit të paguar i të ardhurave personale për çdo fëmijë të porsalindur. Gjithashtu, parashihet mbështetje për firmat punëdhënëse të nënave si lirimi i pagesës së kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe sigurim shëndetësor në rast papunësie, si edhe tatimi i të ardhura personale në periudhë tre vjeçare llogaritur nga dita e punësimit, me detyrimin që punëdhënësi ta mbajë nënën në vendin e punës po aq vite sa shfrytëzohet kjo masë. Janë paraparë deri në gjashtë fekondime pa pagesë in vitro, pa dallim të gjendjes së pasurisë ose numrit të fëmijëve që i ka gruaja.

-Në segmentin programor Bujqësia dhe ushqimi për Maqedoninë, në aspektin Zhvillimi i mjediseve rurale parashihen projekte për mbështetjen e grave fermere.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 (fragmente)

Kapitulli I. Standard cilësor jetësor, - Cikël i ri i rritjes ekonomike

Masa:

Të vetëdijshëm për sfidat demokratike me të cilat përballet Maqedonia dhe shkallët e fertilitetit që po përkeqësohen, Qeveria do t'i avancojë masat ekzistuese dhe do të vërë masa të reja për mbështetjen e prindërve:

-Mbështetje financiare vetëm për një herë për fëmijën e parë;

-Rritje drastike e mbështetjes financiare vetëm për një herë për fëmijën e dytë;

-Vënia e mbështetjes financiare vetëm për një herë për binjakë, për fëmijën e tretë dhe çdo fëmijë të lindur më pas.

Për nënat që janë të punësuara ofrojmë mbështetje financiare shtesë pas përfundimit të pushimit të lindjes:

-Një vjet kthim të tatimit të paguar i të ardhurave personale për fëmijën e parë;

-Dy vjet kthim të tatimit të paguar i të ardhurave personale për fëmijën e dytë;

-Kthim të tatimit të paguar i të ardhurave personale për fëmijën e tretë dhe çdo fëmijë që do të lindë më pas, që do të zgjasë deri në moshën madhore të fëmijës së parë të lindur.

Për firmat që do të punësojnë nëna të tre apo më tepër fëmijëve parashikojmë lirim nga pagesa e kontributeve si lirimi i pagesës së kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe sigurim shëndetësor në rast papunësie, si dhe tatim i të ardhurave personale në periudhë trevjeçare llogaritur nga dita e punësimit, me detyrimin që punëdhënësi ta mbajë nënën në vendin e punës po aq vite sa shfrytëzohet kjo masë.

Do ta vendosim mundësinë çdo grua pa dallim të gjendjes së pasurisë ose numrit të fëmijëve që ka, të përfitojë deri në gjashtë fekondime pa pagesë in vitro.

Zotime:

Mbështetje të projekteve për gratë fermere

Kapitulli IV. Sistem funksional për qytetarët

Në segmentin programor Do të ketë sistem shëndetësor cilësor, është paraparë një aspekt i veçantë Kujdesi për shëndetin e grave përmes ngritjes së vetëdijes për shëndetin e grave dhe hapjen e një qendre të veçantë për fertilizim in vitro në kuadër të Klinikës universitare për gjinekologji dhe akusheri

Kapitulli V. Patriotizmi që bashkon

Në segmentin Siguria dhe mbrojtja, Përforcimi i rolit të gruas në strukturat e sigurisë në polici përmes përfaqësimit të barabartë të grave në pozitat drejtuese në polici.

Në segmentin **Sporti krenari kombëtare** parashihet segment i veçantë **Gruaja në sport**, ku parashihet të vihet theksi në rritjen e përfshirjes së grave dhe vajzave në sportin profesional dhe rekreativ, si dhe mbështetje plotësuese financiare për klubet sportive që do ta mundësojnë këtë dhe promovim të vazhdueshëm të sportit të grave dhe të rezultateve të realizuara sportive.

Kapitulli IV. Sistem funksional institucional

Sistem shëndetësor cilësor
Do të hapim qendër moderne për fertilizim in vitro në Klinikën universitare për gjinekologji dhe akusheri

Kapitulli V. Prioritete kombëtare Siguria dhe mbrojtja

Zotimi:
Përforcimi i rolit të grave paraqet një nga parimet fundamentale të demokracisë. Përfaqësimi adekuat i grave në MPM, MM dhe në institucionet tjera nga sektori i sigurimit dhe i zbulimit do të garantojë respektimin e mirëfilltë të parimeve të barazisë gjinore.

Sporti krenari kombëtare
Nuk ka zotime dhe masa të përfshira

Zotimet dhe masat nga plani 2030 – gjetjet kryesore

Analiza e programit të punës së Qeverisë 2024 – 2028 tregoi se në të nuk janë përfshirë premtimet zgjedhore të Koalicionit „Vlen”. Konkretisht, nuk është përfshirë masa gjinore kuotë 40% gra, gjegjësisht përfshirjen e grave në 40% në të gjitha nivelet, masa për diskriminim pozitiv për pozitat e punës të cilat plotësohen përmes konkursit dhe masa për uljen e tatimit në fitim për bizneset të cilat do të punësojnë të rinj dhe gra.

Përfundime të përgjithshme

Formati në të cilin është përgatitur Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 bazohet në paraqitjen e zotimeve, aktiviteteve dhe masave, synimeve jomjaftueshëm të saktësuar dhe të qarta dhe pranisë së pjesshme të treguesve sasiorë dhe aq më pak të atyre cilësorë. Gjithashtu, në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 nuk veçohen nëntitujt dhe temat siç ishte rasti në programet zgjedhore, gjë që e vështirëson më tej ndjekjen e përfshirjes së disa masave, si dhe përcaktimin për cilat grupe kanë të bëjnë masat e këtilla. Në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 mungonte korniza kohore e realizimit të masave të posaçme, gjë që e vështirëson më tej ndjekjen e realizimit të masave me interes për këtë analizë.

Formati i këtillë e pamundëson opinionin të dijë se cilat janë qëllimet konkrete të cilat duhet të përmbushen në mandatin katërvjeçar të Qeverisë, dhe çfarë rezultatesh priten, gjegjësisht çfarë efekti duhet të japin masat e parapara.

Në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 mungojnë një pjesë e treguesve sasiorë të cilët u premtuan në programin zgjedhor të VMRO-DPMNE-së „Platforma #1198“. Kjo e bën edhe më të vështirë monitorimin e përmbushjes zgjedhore.

Programi i punës së Qeverisë 2024 – 2028 është përgatitur kryesisht në bazë të „Platformës #1198“, ndërsa masat gjinore të cilat u përfshinë në programet e subjekteve tjera politike të cilat tani janë pjesë e Qeverisë, nuk janë trajtuar veçmas, as janë të integruara në mënyrë specifike, gjegjësisht janë përfshirë masat të cilat edhe ashtu ishin planifikuar në Platformën #1198.

Çështjet gjinore

Në lidhje me përfaqësimin e çështjeve gjinore mund të thuhet se pjesa më e madhe e zotimeve dhe masave të cilat VMRO-DPMNE i ka paraparë në Platformën #1198 janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

Çështjet gjinore mbeten relativisht të pasaktësuar deri në fund, sepse për një pjesë të tyre, siç tregoi edhe kjo analizë, nuk ka masa veçse janë trajtuar në nivel zotimesh.

Çështjet gjinore të „Planit 2030“ të Koalicionit „Vlen“, megjithëse janë trajtuar minimalisht vetëm përmes politikave dhe masave multisektoriale, nuk janë përfshirë në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028.

· Duke marrë parasysh formatin e Programit të punës së Qeverisë 2024 – 2028, është e mundur që një pjesë e masave të cilat nuk janë mjaftueshëm të qarta ose të saktësuara, si dhe një pjesë e zotimeve, të përpunohen më tej në kuadër të sektorëve të veçantë dhe të Ministrive. Prandaj, rekomandohet që të planifikohet dhe të zbatohet monitorimi plotësues kombëtar i përfaqësimit të masave të premtuara për çështjet gjinore në strategjitë kombëtare, në strategjitë e ministrive dhe në dokumentet e ngjashme të punës me qëllim që të përcaktohet se vallë do të ketë operacionalizim plotësues të zotimeve, si dhe të atyre masave të cilat nuk janë mjaftueshëm të saktësuara apo për të cilat mungojnë treguesit e qartë.

· Rekomandohet që planifikimi i ardhshëm i Qeverisë dhe i Ministrive për vitin 2025 edhe më tej të përfshijë qëllime specifike, afate kohore, rezultate të qarta e të pritshme dhe tregues sasiore të cilat do të mundësojnë monitorimin e përmbushjes së premtimeve të dhëna.

· Rekomandohet zgjerimi i mëtejshëm i rezultateve të kësaj analize me qëllim që të arrijnë te opinioni publik d.m.th. në mënyrë të drejtpërdrejtë te qytetarët dhe në atë mënyrë qytetarët të informohen cili është vendi i prioriteteve të tyre në Programin e punës së Qeverisë 2024 – 2028 dhe të zotohen për implementimin e tyre.

· Rekomandohet organizatat qytetare të cilat veprojnë në nivel vendor të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të programeve vjetore për punën e vetëqeverisjeve vendore që të përcaktohet vallë disa nga masat për çështjet gjinore do të transponohen në nivelin vendor, në cilën formë dhe të përcaktohet plani i mëtejshëm për monitorimin e realizimit të tyre. Kjo veçanërisht rekomandohet për monitorimin e programeve të vetëqeverisjeve vendore përmes të cilave do të realizohet mbështetja e premtuar prej 250 milionë eurosh për vetëqeverisjet vendore.

· Organizatat qytetare duhet t'i përfaqësojnë kërkesat e tyre në Qeveri, ministritë kompetente dhe agjencitë me qëllim që ajo pjesë e programeve në të cilat janë përfshirë zotimet të operacionalizohet në masa konkrete dhe të njëjtat të implementohen më tej.